

RELACION

Mbi

Raportet e monitorimit për vitin 2020

Gjatë periudhës Janar - Gusht, Gjykata e Lartë ka bërë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore duke zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fuqi.

Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë për këtë periudhë është në shumën 129029.6 mijë leke. Kemi shtese fondi në art.602 prej 326 mijë lekë për “Shpenzime për përballimin e situatës nga Covid 19” si dhe shtese fondi ne artikullin 600 dhe 602 për KED-in. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi fond të çelur në art. 606 “Transferta për buxhet familjar dhe individë” në shumën 403.1.6 mijë lekë.

Buxheti i realizuar është 123343 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

Në 000 lekë

Artikulli	Emertimi	Buxheti Viti 2020. Ne fillim	Buxheti Viti 2020. I rishikuar	Realizimi Viti 2020
230	PROJEKT	300	0	0
231	INVESTIME GJITHSEJ	4,930	5,230	4829.3
600	PAGA	122,400	97,200,000	92,373
601	KONTRATA ME SIG.SHOQËRORE	10,600	10,700,000	10,668
602	MALLRA E SHERBIME TË TJERA	20,000	21,123,000	15,075.20
606	TRANSFERIME PËR BUXHET FAMILJAR & INDIVIDUAL		403.1	396.2
		158,230	129,028.6	123,343

ANEKSI nr.1 “Raporti i shpenzimeve sipas Programeve”

ANEKSI nr.2 “Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetore”

Në te dyja keto anekse shohim se gjatë këtij viti kemi mosrealizim në shumën 11593.5 mijë lekë me planin e rishikuar.

Sipas artikujve kemi mosrealizim në art.600 diferenca është në shumën -4826.6 mijë leke dhe art.601 diferenca është 31.6 mijë lekë. Kjo për arsye të rishikimit të fondit vjetor, të mos plotësimit të numrit të punonjësve të planifikuar në organikë. Gjithashtu gjykatës i’u akordua një shtesë fondi në fund të vitit i cili duhej të përdorej për shpërblimin e anëtarëve të KED-se dhe stafit mbështetës, por për shkak të pandemisë COVID-19 dhe mungesës së një numri të anëtarëve ky fond nuk u përdor i gjithë.

Në art .602 kemi një diferencë prej 6247.8 mijë lekë.

Në zrin Shpenzime për mallra e shërbime, gjatë vitit 2020 janë planifikuar dhe realizuar me procedure prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” në mënyrë elektronike si dhe me procedure “me vlere nën 100 mijë leke”: shërbim internet, larje makinash, mirëmbajtje ashensori, hostim i faqes ëeb të Gjykatës së Larte, siguracioni i mjeteve të transportit, mirëmbajtje të paisjeve elektrike e teknike, (kondicionerë, gjeneratorë), mirëmbajtje mjete transporti, abonime, botime, mirëmbajtje sistem sigurie, mirëmbajtje sistem kundra zjarrit, blerje goma, automjetesh, shërbim printimi, shtypshkrime, blerje uniforma, etj., për të cilat janë lidhur kontratat respektive me afat deri 31.12.2020.

Përsa i përket realizimit të shpenzimeve në zërat e mësipërm, janë realizuar shpenzimet për kancelari në shumën 245.7 mijë lekë, material pastrim disinfektim në shumën 361.3 mijë lekë, shtypshkrime 100 mijë lekë, abonime e njoftime në shumën 103.6 mijë lekë, internet në shumën 106.9 mijë lekë, karburant në shumën 1613 mijë lekë, goma makine 191 mijë lekë, larje makine 130.4 mijë lekë, siguracion automjetesh 403 mijë lekë, pjese këmbimi 191 mijë lekë, mirëmbajtje ashensori 108 mijë lekë, mirëmbajtje elektrike hidraulike 109.6 mijë lekë, mirëmbajtje gjeneratori 99.5 mijë lekë, mirëmbajtje godine 918 mijë lekë, etj..

Shpenzimet për shërbime: energji elektrike, ujë, telefon, postë, etj., janë realizuar sipas planifikimit buxhetor.

Po kështu, jane realizuar shpenzimet për: tatim e taksa, pritje, udhëtim e dieta, kuotizacion, etj., si më poshtë:

Shpenzime tatim e taksa në shumën 315 mijë lekë; shpenzime kuotizacioni 252 mijë lekë; dieta e udhëtime jashtë vendit në shumën 504 mijë leke dhe dieta administrative 93 mijë lekë.

Për këtë vit janë zhvilluar tenderat me procedurë “Marrëveshje kuadër” si më poshtë:

- 1- Mirëmbajtje mjete transporti - shoqëria e shpallur fituese është firma “Kadiu” sh.a. në vlerë 1872 mijë lekë dhe është në fazën e ekzekutimit të kontratës.
- 2- Shërbim printimi – përfunduar - shoqëria e shpallur fituese është firma “Infosoft Office” sh.a. me vlerë 1354 mijë lekë dhe është në fazën e ekzekutimit të kontratës.
- 3- Blerje karburanti - përfunduar - shoqëria fituese është “Das Oil” me fond 768 mijë lekë dhe është përfunduar ekzekutimi i kontratës.

Në art.606 në këtë periudhë kemi çelje fondi në “Transferta tek individët” në Shumën 303 mijë lekë, për “Shpërblim për pension pleqërie” të punonjësve të institucionit.

Në artikullin 231 “Kapitale të trupëzuara” janë planifikuar:

- 1420 mijë lekë për Blerje Pajisje e ndare në; “Blerje pajisje mobilje” në Shumën 960 mije leke dhe “Blerje kondicionerë” në vlerën 460 mijë lekë.
- Për blerje pajisje sigurie janë planifikuar 1750 mijë lekë.
- Për blerje pajisje elektronike janë planifikuar 2060 mijë lekë.

Është realizuar procedura e prokurimit me “Blerje me vlerë të vogël” për blerjen e kondicionerëve. Është lidhur kontrata me firmën fituese “Superior klima”, në vlerën 431 mijë lekë, dhe është bërë likuidimi i saj.

Për fondin 960 mijë lekë planifikuar për blerje mobilje, është realizuar procedura elektronikisht, me “Blerje me vlerë të vogël”, - shpallur fitues firma “Erzeni” sh.p.k. në vlerën 752 mijë lekë, është lidhur kontrata, është bërë likuidimi i saj.

Në lidhje me pjesën tjetër të fondit në shumën 2060 mijë lekë për blerje “Pajisje Elektronike” është realizuar procedura elektronikisht, me “Kërkesë për propozim”, është shpallur fitues firma “Infosoft Office” sh.p.k. në vlerën 1693 mijë lekë, është bërë likuidimi i saj.

Për fondin 450 mijë lekë për “Blerje Pajisje Sigurie” është realizuar procedura elektronikisht, me “Blerje me vlerë të vogël”, është shpallur fitues firma “Coratel” sh.p.k. në vlerën 384 mijë lekë, është lidhur kontrata, është bërë likuidimi i saj.

Gjithashtu është realizuar procedura elektronikisht me tender për blerje pajisje sigurie (skaner bagazhesh) me fond 1300 mijë, është shpallur fitues firma “A&A Security Survey” në vlerën 1272 mijë, është lidhur kontratë dhe është bërë likuidimi i saj.

Për artikullin 602 kemi mosrealizim në shumën 6247.8 mijë. Si rezultat i mosplotësimit të numrit të gjyqtarëve dhe punonjësve nuk u realizuan shpenzimet e planifikuara për karburant, larje makine, siguracion makine, shërbim printimi, etj.. Për shkak të pandemisë Covid-19 nuk u realizuan dhe udhëtimet e planifikuara për jashtë shtetit. Gjithashtu në këtë mosrealizim ka ndikuar dhe shtesa e fondit që është akorduar për shpenzime operative për KED-in. Në fakt për vitin 2020 KED, kishte shumë pak shpenzime operative.

ANEKSI Nr.3 “Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit.

Në lidhje me produktin A “Çështje të Gjykuara” shohim se kemi një ulje të kostos krahasuar me vitin 2019, kjo si rezultat i plotësimit të organikes me 3 gjyqtare.

Në produktin F “Mobilje” kemi planifikuar 1420 mijë lekë për vitin 2020 dhe është lidhur kontrata në vlerën 752 mijë lekë për blerje pajisje mobilje dhe është realizuar dhe likuiduar kontrata për blerje kondicionerë në shumën 431 mijë lekë.

Në produktin G “Elemente sigurie për gjykatën” kemi planifikuar 450 mijë lekë. Si dhe është bërë rialokim fondi në Shumën 1300 mijë lekë. Janë realizuar si procedura, janë lidhur kontrata dhe janë likuiduar.

Në Produktin K “Pajisje elektronike për gjykatën” janë planifikuar 2060 lekë për tetë mujorin e parë të këtij viti dhe është realizuar procedura, lidhur kontrata dhe likuiduar në shumën 1693 mijë lekë.

ANEKSI 4. Produktet e investimeve me financim të brendshëm

Në aneks shohim se është planifikuar fondi për gjithë vitin 2020, në shumën 5230 mijë lekë.

Me kod projekti 18 AD801 “Mobilje –Pajisje” në Shumën 1420 mijë lekë është realizuar deri në Dhjetor 2020.

Me kod projekti 18AD804 “Blerje pajisje sigurie” në Shumën 450 mijë lekë është realizuar deri në Dhjetor 2020.

Me kod projekti M290072 “Blerje pajisje elektronike” fondi është parashikuar 2060 mijë lekë, është lidhur kontrata me fond 1693 mijë lekë dhe është realizuar deri në Dhjetor 2020.

Në lidhje me kod projekti M290066 “Projekt” në shumën 300 mijë lekë dhe kod projekti M290068 “Rikonstruksion” në Shumën 1000 mijë lekë është bërë rialokim fondi me miratim nga Ministria e Financave dhe ky fond është përdorur për blerje pajisje sigurie.